



VLERËSIMI I SHËRBIMEVE LOGJISTIKE NË KOSOVË



Përgatitur për:

Departamenti i Tregtisë, MINT

Përgatitur nga:

Agon Nixha, *Konsulent i Jashtëm*

Me kontribut nga Departamenti i Tregtisë, MINT:

Mirsad Simnica,
Albina Bujupi Doberdolani
dhe Gentiana Rustemi

Ky raport është hartuar si pjesë e Asistencës Teknike në Kontekstin e Integritimit Evropian të zbatuar nga Zyra e Kryeministrit dhe mbështetur nga Dukata e Madhe e Luksemburgut

[Versioni origjinal është në gjuhën angleze]

Mirënjohje:

Autori shpreh mirënjohje të thellë për stafin e Departamentit të Tregtisë për mbështetjen e tyre në hartimin e këtij raporti.

Publikimi i punimit: 01/2021

Maj 2021

Vendi:

Prishtinë, Kosovë

Faqja e kopertinës së këtij raporti është dizajnuar duke përdorur burime nga Freepik.com.

Mohim i Përgjegjësisë:

Pikëpamjet e shprehura këtu i përkasin autorit dhe kësaj nuk mund të merren në asnjë mënyrë si mendim zyrtar i donatorit mbështetës.

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtesat	5
Përmbledhja ekzekutive.....	6
1. Hyrje	10
2. Metodologjia e përgjithshme.....	12
3. Trendet ndërkombëtare	13
4. Struktura dhe performanca e sektorit të logjistikës në Kosovë.....	16
5. Korniza rregullatore	23
5.1. Hyrja në treg	23
5.2. Operimet	28
5.3. Marrëveshjet dhe Protokollet Ndërkombëtare	29
5.4. CEFTA - Protokoli Shtesë 6	31
6. Gjetjet kryesore të anketës.....	33
7. Përfundim	40
Shtojcat	41

Figurat

Figura 1: Shpërndarja e firmave aktive të logjistikës (sipas të dhënave të ATK-së) sipas rajoneve	18
Figura 2: Firmat e logjistikës (sipas të dhënave të ARBK-së) sipas gjinisë së pronarëve	19
Figura 3: Firmat e logjistikës sipas gjinisë	19
Figura 4: Vendndodhja sipas rajonit, në %.....	33
Figura 5: Shërbimet kryesore të ofruara nga firmat, në% të rasteve	34
Figura 6: Shpërndarja e punësimit, në %	34
Figura 7: Shpërndarja e pagës mesatare, në %.....	35
Figura 8: Ndryshimi vjetor i qarkullimit në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, në%.....	35
Figura 9: Lloji i klientëve, në %.....	36
Figura 10: Niveli i perceptuar i konkurrencës së sektorit krahasuar me BE, në %	36
Figura 11: Angazhimi në transportin ndërkufitar të mallrave, në %.....	37
Figura 12: Stimujt nga qeveria, në%	38
Figura 13: Renditja e pengesave nga firmat (mesatarja)	39

Tabelat

Tabela 1: Numri i firmave aktive të logjistikës, sipas nënsektorëve	17
Tabela 2: Firmat e regjistruara dhe të mbyllura të logjistikës (2001-2020)	17
Tabela 3: GVA në sektorin e logjistikës në Kosovë	20
Tabela 4: Qarkullimi i kombinuar i firmave të logjistikës (2017-2019).....	20
Tabela 5: Personat e punësuar në sektorin e logjistikës (2018-2019).....	21
Tabela 6: Tregtia e transportit të mallrave	22
Tabela 7: Një përmbledhje e licencave për transportin ndërkombëtar	26
Tabela 8: Një listë përmbledhëse e standardeve të emetimit të BE-së.....	29
Tabela 9: Marrëveshjet ndërkombëtare të transportit dhe protokollet teknike të Kosovës	31

Shkurtesat

AP6	Protokolli Shtesë 6
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
ECMT	Konferenca Evropiane e Ministrave të Transportit
BE	Bashkimi Evropian
GATS	Marrëveshja e Përgjithshme për Tregtinë e Shërbimeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
BVSH	Bruto Vlera e Shtuar
IFC	Korporata Ndërkombëtare Financiare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HCDF	Mekanizmi për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore
IRU	Sindikata e Transportit Rrugor
JIT	Mu në kohë
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
SH.P.K.	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
KMF	Kombi më i favorizuar
NACE	Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
KST	Kushtet Standarde të Tregtimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
MB	Mbretëria e Bashkuar
UNMIK-u	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
SH.B.A.	Shtetet e Bashkuara
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë

Përmbledhja ekzekutive

Ky raport paraqet një vlerësim të sektorit të logjistikës në Kosovë. I njëjti analizon strukturën dhe performancën e sektorit, shqyrton kornizën përkatëse rregullatore për shërbimet e logjistikës bazuar në *Acquis* të BE dhe identifikon pengesat kryesore me të cilat përballen ofruesit e shërbimeve logjistike. Shërbimet logjistike, të cilat përfshijnë aktivitete të cilat kanë të bëjnë me qarkullimin e mallrave (transport dhe magazinim) në të gjithë zinxhirin e vlerës, janë thelbësore në aspektin e rritjes ekonomike, punësimin gjithëpërfshirës dhe tregtinë ndërkombëtare me cilësi të lartë. Për shkak të natyrës së tyre ndër-sektoriale, shërbimet logjistike kanë efekte të shumëfishta në ekonomi. Sektorë të rëndësishëm siç janë bujqësia, metalurgjia dhe minierat, përpunimi i ushqimit, prodhimi i drurit, të gjithë varen nga funksionet e logjistikës.

Në Kosovë, ofruesit e shërbimeve logjistike kontribuojnë me 3.2 për qind në Bruto Vlerën e Shtuar të vendit (BVSH). Megjithatë kjo nuk është përqindje e vogël në krahasim me sektorët e tjerë në ekonominë e vendit, është dukshëm më e vogël krahasuar me mesataren e BE-së dhe OECD-së. Numri i ofruesve aktivë të shërbimeve logjistike në Kosovë është 20 herë më i vogël krahasuar me mesataren e BE-së. Një arsye kryesore për këtë dallim lidhet me faktin se nën-kontraktimi i funksioneve logjistike nuk është praktikë shumë e shpeshtë në Kosovë. Për më tepër, të dhënat tregtare tregojnë se Kosova ka regjistruar deficit të vazhdueshëm tregtar në transportin e mallrave, i cili është trend i ndryshëm krahasuar me performancën e përgjithshme të vendit në tregtinë e shërbimeve.

Për shkak të natyrës komplekse dhe shumë-dimensionale të sektorit të logjistikës, korniza rregullatore në Kosovë, si në shumë vende të tjera, karakterizohet me nivel të lartë të fragmentimit, si dhe me legjislacion dhe rregullore të shpërndara në institucione të ndryshme.

Gjatë rishikimit të rregulloreve të hyrjes (qasjes) në treg janë identifikuar disa çështje, të cilat zakonisht përbëhen nga kërkesat e regjistrimit dhe licencimit për operatorët e rinj që do të pranohen në treg. Së pari, në BE kërkohet licencë për të gjithë operatorët e transportit rrugor, ndërsa në Kosovë kjo kërkesë është vetëm për ata që merren me transport ndërkombëtar të mallrave. Në mungesë të kërkesës së tillë, tregu i brendshëm i transportit rrugor vuan nga shërbimet me cilësi të dobët dhe çështjet e sigurisë rrugore. Edhe kushtet e licencimit (kriteret) për operatorët që synojnë të bëjnë transport rrugor ndërkombëtar, të tilla si ato të themelimit, reputacionit të mirë dhe të ngjashme, nuk janë përcaktuar aq mirë, duke lënë hapësirë për keqinterpretim. Në pjesë të caktuara, kushtet e licencimit nuk janë plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE-së. Së dyti, nuk ka regjistër kombëtar të disponueshëm për publikun të operatorëve të transportit rrugor që kanë licencë, pavarësisht faktit se kjo është kërkesë nga legjislacioni në fuqi. Së treti, kriteret për transportuesit jo-rezidentë të cilët kanë nevojë për të marrë leje transporti nuk përcaktohen me legjislacionin aktual. Në fakt, ekziston një udhëzim administrativ i trashëguar nga periudha e UNMIK-ut që rregullon lejet për transportuesit jo-rezident rrugor; megjithatë, ky akt juridik nuk specifikon kriteret për marrjen e lejes. Së katërti, ndryshe nga Kosova ku transportuesit jo-rezidentë nuk mund të kryejnë transport rrugor të mallrave brenda vendit (kabotazh), në BE jo-rezidentët mund të kryejnë deri në tre operime në Shtetet Anëtare pritëse brenda shtatë ditëve pas udhëtimit ndërkombëtar. Së pesti, kërkesat për licencimin e terminalit të përcaktuara në legjislacionin ekzistues dhe mënyra e zbatimit të tyre kanë krijuar shtrembërime në treg, duke rezultuar, ndër të tjera, në tarifa relativisht të larta terminale për transportuesit. E fundit, përfaqësuesit e doganave (shpesh të

referuar si ndërmjetës) janë të detyruar të marrin licencë për të vepruar në Kosovë, ndryshe nga BE-ja ku nuk ka kërkesë të tillë.

Gjatë rishikimit të rregulloreve të operimeve, të cilat zakonisht synojnë të promovojnë cilësinë e shërbimeve, janë identifikuar disa çështje kyçe. Së pari, koha e vozitjes, pauzat dhe periudhat e pushimit për shoferët në transportin e mallrave, me gjithë faktin se janë të rregulluara në përputhje me praktikën e BE-së, nuk zbatohen mirëfilli. Së dyti, çështjet e përgjegjësisë në rastet e humbjeve dhe dëmeve, të cilat janë shumë të rëndësishme në kontaktet logjistike, nuk janë të rregulluara mirë. Së treti, ndryshe nga BE-ja e cila ka standarde të emetimit dhe ku respektimi i tyre është i detyrueshëm, në Kosovë nuk ka kufizime të vendosura për transportuesit që kryejnë transport rrugor brenda vendit.

Si rezultat i vështirësive për anëtarësimin në mekanizmat ndërkombëtarë të transportit, duke filluar nga viti 2010, Kosova ka lidhur marrëveshje bilaterale të transportit me disa vende të BE-së dhe me disa vende fqinje. Këto marrëveshje bilaterale ndryshojnë nga njëra-tjetra në shumë aspekte, kryesisht në lidhje me shkallën e liberalizimit. Bazuar në intervistat me palët e interesit, nga të gjitha marrëveshjet në fuqi, ajo me Turqinë u perceptua si më e pafavorshme, veçanërisht për shkak se numri i lejeve vjetore konsiderohet të jetë disproporcionalisht më i ulët për Kosovën. Standardet e emetimeve janë fushë tjetër në të cilën këto marrëveshje kanë dallime. Në përgjithësi, pajtueshmëria me dispozitat divergjente të marrëveshjeve bilaterale konsiderohet si barrë e rëndësishme rregullatore për operatorët e transportit.

Për të mbledhur më shumë njohuri mbi sektorin, është bërë një anketë me mostër të ofruesve të shërbimeve logjistike. Gjetjet e anketës tregojnë se firmat e logjistikës në Kosovë kryesisht varen vetëm nga një shërbim, i cili në shumicën e rasteve është transporti. Ky model biznesi nuk është në përputhje me dinamikën e re globale, ku firmat e logjistikës janë specializuar në sigurimin e paketave të integruara të shërbimeve logjistike, përfshirë shërbimet me vlerë të shtuar si paketimi, menaxhimi i inventarit dhe të ngjashme. Gjetjet tregojnë gjithashtu se pandemia Covid-19 ka goditur në mënyrë të konsiderueshme sektorin në vitin 2020, duke shkaktuar rënie të qarkullimit tek më shumë se dy të tretat e firmave. Për më tepër, firmat besojnë se niveli i konkurrueshmërisë (çmimi dhe cilësia) qëndron më keq krahasuar me BE-në.

Sipas firmave të anketuara, pikat e forta kryesore që karakterizojnë sektorin janë infrastruktura rrugore dhe shpejtësia e dërgimit. Nga ana tjetër, disa nga pikat e dobëta të identifikuara përfshijnë konkurrencën e padrejtë, çmimet e larta të terminalit, mungesa e tahografëve digjitalë, automjetet e vjetra, pagesat e vonuara dhe shoqëri me funksionim të dobët. Shumica e firmave të anketuara janë të angazhuara në transportin ndërkombëtar të mallrave. Këto firma duket se përballen me shumë pengesa gjatë kryerjes së tregtisë ndërkufitare. Disa nga pengesat e përmendura më shpesh përfshijnë pamundësinë e transportuesve për tu futur në zonën e BE-së pa viza; kosto të larta sigurimi në mungesë të sistemit të kartonit të gjelbër; kërkesa për të ndryshuar targat në kufirin serb dhe pengesat e tjera që burojnë nga mosnjohja e dokumenteve; vështirësitë që vijnë nga mos-anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë si ECMT; dhe regjimi diskriminues i lejeve me vendet e tjera.

Rekomandimet kryesore të këtij raporti janë përshkruar më poshtë:

- Qeveria duhet të krijojë mekanizëm efektiv rregullator dhe koordinues i cili lidh organet e ndryshme rregullatore dhe ato të kontrollit të cilat përcaktojnë dhe zbatojnë rregulloret për shërbimet logjistike. Diçka e tillë, ndër të tjera, do të përmirësojë koherencën në politikë-bërje dhe minimizon burokracinë në sektor.

- Në përgjithësi, korniza rregullatore duhet të modernizohet për të mirëmbajtur shërbime logjistike me cilësi të lartë. As rregullimi i tepërt dhe as derregullimi nuk do të jenë të shëndetshme për funksionimin e duhur të sektorit të logjistikës.
- Duhet të forcohet roli i shoqatave sektoriale. Ato duhet të kenë rol udhëheqës në bashkimin e anëtarëve të tyre dhe t'i ndihmojnë ata të ndjekin rregullat që kontribuojnë në bërjen e sektorit më konkurrues. Ato mund të shërbejnë edhe si vetë-rregullatorë, veçanërisht në rastet kur Qeveria ngeçë në miratimin e praktikave të reja.
- Përveç kërkesës për licencim për transportuesit rrugorë të angazhuar në transportin ndërkombëtar, Qeveria duhet të prezantojë një kërkesë për licencim për transportuesit që kryejnë operime brenda vendit. Kjo do të ishte në harmoni me praktikën e BE-së. Kriteret për krijimin, reputacionin dhe kapacitetin financiar duhet të jenë mjaft të qarta dhe specifike për të shmangur keqinterpretimin, i cili është shumë i shpeshtë në këto raste. Nga ana tjetër, lëshimi i lejeve për operatorët jo-rezidentë duhet të rregullohet më mirë me udhëzim të ri administrativ. Çështjet e zbatimit duhet të adresohen gjithashtu me më shumë kontrolle dhe auditime.
- Qeveria duhet të krijojë regjistër të brendshëm miqësor për përdoruesit e transportit dhe operatorëve të tjerë të logjistikës që posedojnë licenca dhe leje në mënyrë që të përmirësojë transparencën në sektor. Ky regjistër duhet të jetë i qasshëm për publikun, por duke mos shpalosur informacionin që cenon privatësinë e operatorit.
- Qeveria duhet të vlerësojë me kujdes dispozitat e hyrjes në treg për terminalin e mallrave dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme për të adresuar shtrembërimet e krijuara nga tendencat oligopole.
- Në përputhje me praktikën e BE-së, Qeveria duhet të vlerësojë mundësinë e ndryshimit të legjislacionit për të lejuar transportuesit rrugorë jo-rezidentë të kryejnë deri në tre operime kabotazhi në Kosovë brenda shtatë ditëve pas udhëtimit ndërkombëtar.
- Qeveria duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për t'u bërë anëtare e mekanizmave ndërkombëtarë të cilat rregullojnë transportin ndërkufitar si ECMT. Meqenëse procesi i anëtarësimit mund të marrë kohë dhe epilogu do të ishte ende i pasigurt, Kosova duhet, ndërkohë, të zgjerojë shtrirjen gjeografike të marrëveshjeve të saj bilaterale. Gjithashtu, marrëveshjet ekzistuese bilaterale, veçanërisht ajo me Turqinë, duhet të rishikohen nga afër dhe të njëjtat mund të ri negocohen.
- Në ndjekje të praktikës së BE-së, Kosova duhet të heqë kërkesën për licencim për përfaqësuesit e doganave.
- Palët e përfshira në marrëveshje logjistike, me rastin e hartimit të kontratave të tyre, duhet t'i referohen Kushteve Standarde të Tregtisë (KST) për të shmangur çështjet e përgjegjësisë në rastet e dëmtimit dhe humbjes.
- Qeveria duhet të prezantojë rregulla të detyrueshme të avancimit të flotës për të zbutur dëmtimin e mjedisit në përputhje me standardet dhe kriteret e vendosura në direktivat përkatëse të BE-së.
- Qeveria duhet të ofrojë stimuj që stimulojnë zhvillimin e shërbimeve të integruara logjistike (3PL). Diçka e tillë do të rrisë performancën e sektorit dhe ta bëjë atë në përputhje me trendet e reja globale. Këto stimuj duhet të vijnë me kërkesa të veçanta ose kufizime. Digjitalizimi duhet të jetë njëra nga kërkesat.
- Për të përmirësuar transparencën, duhet të hartohet lista kontrolluese e plotë dhe gjithëpërfshirëse e procedurave të nevojshme për secilin aktivitet specifik.
- Qeveria e Kosovës duhet të negociojë me Serbinë për të hequr pengesat e pajustificueshme të vendosura mbi transportuesit e Kosovës kur i dërgojnë mallrat në formë transiti drejt BE.

- Firmat logjistike që kanë regjistruar rënie në qarkullim duhet të merren parasysh nga qeveria me rastin e hartimit të pakove të mëposhtme të rimëkëmbjes ekonomike.
- Duhet prezantuar monitorim koherent dhe i rregullt i performancës së sektorit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për opsionet dhe veprimet e politikave të reja. Përgjigjet e mira dhe në kohë të politikave kërkojnë bazë të përmirësuar informacioni mbi gjendjen e sektorit.
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK) duhet të bëjë të gjithë punën e nevojshme për të qenë në gjendje të prodhojë të dhëna më të disagreguara mbi tregtinë e shërbimeve në mënyrë që politikë-bërësit dhe studiuesit e tjerë të interesuar të vlerësojnë më mirë performancën dhe trendet e shërbimeve specifike logjistike.
- Qeveria duhet të punojë me Bankën Botërore për të gjeneruar Indeksin e Performancës Logjistike (LPI). LPI është indeks i njohur i aplikuar në 160 vende të botës. Konkretisht i njëjti mat situatën e sektorit të logjistikës në vend.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishme, strategjia për shërbimet, ku logjistika përfshihet midis sektorëve prioritarë, duhet të jetë gjithashtu pjesë e agjendës së Qeverisë. Duhet të shqyrtohet gjithashtu një politikë e veçantë logjistike afatmesme dhe afatgjatë, e fokusuar në fushat kryesore problematike.

1. Hyrje

Shërbimet janë segment i madh dhe vital në Kosovë, që përbënë 73 për qind të ekonomisë së vendit dhe kontribuon në rreth 85 për qind të punësimit formal.¹ Shërbimet gjithashtu luajnë rol thelbësor në tregtinë e jashtme të Kosovës, duke përbërë 35 për qind të tregtisë së përgjithshme të jashtme.² Një aspekt i rëndësishëm në këtë drejtim është se Kosova ka regjistruar vazhdimisht bilanc tregtar pozitiv në tregtinë e shërbimeve, ndryshe nga tregtia e mallrave, ku deficitin ka qenë jashtëzakonisht i lartë. Sektor i rëndësishëm i shërbimeve në Kosovë është ai i logjistikës, i cili përfshin aktivitete që kanë të bëjnë me qarkullimin e mallrave (transportin dhe magazinimin) në të gjithë zinxhirin e vlerës. Në vitin 2019, ofruesit e shërbimeve logjistike përbënin rreth 3.2 për qind të BVSH të Kosovës, duke shënuar rritje prej një pikë përqindjeje krahasuar me 2017. Në shumë kompani përpunuese në Kosovë, këto shërbime janë pjesë e funksioneve të tyre të brendshme. Nëse do të merrej në konsideratë ky aspekt, pjesa e kontributit të sektorit të logjistikës në GVA do të kishte qenë edhe më e lartë.

Në përgjithësi, sektori i logjistikës, përveç që është i rëndësishëm në vetvete, i njëjti është gjithashtu thelbësor për sektorët e tjerë për shkak të natyrës së tij ndër-sektoriale. Kompanitë e minierave dhe metaleve, prodhuesit bujqësorë, përpunuesit e drurit, kompanitë farmaceutike, kompanitë e përpunimit të ushqimit etj., të gjitha varen nga shërbimet logjistike. Duke marrë parasysh atë që u tha, një sektor i logjistikës joefikas dhe i pazhvilluar mund të jetë problem serioz për ekonominë, duke çuar në më pak mundësi punësimi, duke e bërë të vazhdueshëm ciklin e varfërisë për grupet e cënueshme, duke penguar tregtinë ndërkombëtare dhe duke kontribuar në ndotjen e mjedisit. Në të kundërt, një sektor i logjistikës i fortë dhe efikas mund të lehtësojë rritjen ekonomike me cilësi të lartë, duke gjeneruar punësim gjithëpërfshirës, duke rritur tregtinë ndërkombëtare dhe duke përmirësuar sigurinë publike.

Ashtu si shumë sektorë të shërbimeve në Kosovë, edhe sektori i logjistikës përballet me pengesa të llojeve të ndryshme. Raporti i BE-së për Kosovën 2020 konstaton se Kosova ka shënuar progres të kufizuar në identifikimin dhe heqjen e pengesave në lidhje me të drejtën e themelimit dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve, si dhe në përafrimin e pjesëve të legjislacionit të shërbimeve me *Acquis* të BE-së, sipas zotimeve në Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA).³ Për të identifikuar pengesat më urgjente rregullatore dhe pengesat e tjera, për të rishikuar harmonizimin me *Acquis* të BE dhe, në përgjithësi, për të pasur të kuptuar më të mirë të sektorëve të shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Departamenti i Tregtisë, në veçanti, ka planifikuar të kryejë një sërë vlerësimesh specifike sektoriale. Duke ndjekur këtë plan, MINT ka përgatitur këtë raport vlerësimi. Ky raport vë në pah strukturën dhe performancën e sektorit të logjistikës, shqyrton kornizën përkatëse rregullatore për shërbimet logjistike në saktë të *Acquis* të BE-së dhe identifikon pengesat kryesore me të cilat përballen ofruesit e shërbimeve logjistike. Fushëveprimi i këtij vlerësimi është hartuar përgjithësisht për t'u fokusuar më shumë në aspektet tregtare të sektorit, duke pasur parasysh interesin e Departamentit të Tregtisë.

Ky vlerësim u bë i mundur me mbështetjen e Mekanizmit për Zhvillimin e Kapaciteteve Njerëzore (HCDF), i cili është mekanizëm i krijuar me ndihmën e donatorëve të Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe

¹ Përpilimi i autorit bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës.

² Raporti i tregtisë me mallra. Në dispozicion në MINT.

³ Komisioni Evropian (2020) Raporti për Kosovë * 2020. I qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

Mbretërisë së Norvegjisë, për të mbështetur zbatimin e MSA-së ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE).

Pjesa tjetër e këtij raporti është strukturuar si në vijim. *Seksioni 2* ofron pasqyrë të përgjithshme të metodologjisë së përdorur për të kryer këtë vlerësim. *Seksioni 3* thekson trendet kryesore globale që karakterizojnë shërbimet logjistike. *Seksioni 4* ofron përmbledhje të strukturës dhe performancës së sektorit duke u mbështetur në statistikat makro. *Seksioni 5* ofron diskutim për kornizën ligjore që rregullon sektorin, kryesisht duke u fokusuar në dispozitat që lidhen me hyrjen në treg dhe operimet, si dhe bën krahasime me praktikën e BE-së. *Seksioni 6* paraqet gjetjet kryesore të anketës së kryer me një mostër të operatorëve të logjistikës. *Seksioni 7* është përmbyllje e raportit.

2. Metodologjia e përgjithshme

Për të marrë njohuri përkatëse dhe për të pasur të kuptuar më të mirë në lidhje me sektorin e logjistikës janë përdorur instrumentet e mëposhtëm të mbledhjes së të dhënave: (i) hulumtim i dokumenteve në zyrë (ang. “desk research”) (ii) intervista të hapura me akterët përkatës; (iii) anketë gjysmë e strukturuar online/me telefon; dhe (iv) në fund takim validues me përfituesin. Të gjitha këto burime të informacionit të kombinuara u konsideruan të rëndësishme për analizën gjithëpërfshirëse dhe bazë të sektorit.

Siç ndodh zakonisht, hulumtimi i dokumenteve në zyrë u krye në fillim të analizës. Së pari u konsultuan raporte dhe studime të ndryshme me qëllim përcaktimin e bazave konceptuale të sektorit dhe ekzaminimin e trendeve dhe zhvillimeve ndërkombëtare. Së dyti, korniza përkatëse legislative dhe institucionale në Kosovë u rishikua dhe u krahasua me *Acquis* e BE-së për t’i identifikuar fushat që kanë nevojë për harmonizim në të ardhmen. Informacioni i mbledhur përmes hulumtimit të dokumenteve në zyrë u analizua nga afër, u ruajt dhe u klasifikua bazuar në burimin, rëndësinë dhe besueshmërinë. I gjithë ky proces, ndër të tjera, shërbeu si bazë për hulumtimin primar dhe për aktivitetet e tjera pasuese të kryera në këtë analizë.

Intervistat e hapura u aranzhuan dhe u kryen (si me prezencë fizike ashtu edhe virtualisht) me akterët kryesorë institucionalë të identifikuar. Shikoni listën e akterëve të intervistuar në Shtojcën A. Së bashku me përfaqësuesit e MINT-it, një grup pyetjesh udhëzuese u hartuan për këto takime.

Për të kërkuar informacion më të hollësishëm mbi performancën dhe pengesat e sektorit, u krye një anketë online/me telefon me 51 firma ekonomikisht aktive të shpërndara në rajone të ndryshme të Kosovës që operojnë në fushën e shërbimeve logjistike. Mostra është nxjerrë kryesisht nga bazat e të dhënave të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Për gjetjen e informacioneve të kontaktit për firmat e përzgjedhura janë përdorë edhe burime të tjera.

Për qëllimin e kësaj ankete u hartua një draft pyetësor (shih Shtojcën B). Ky draft u pilotua fillimisht me një ofrues të shërbimeve për t’u siguruar që të gjitha pyetjet janë të qarta dhe të drejtpërdrejta. Finalizimi i pyetësorit u bë në bashkëpunim me Departamentin e Tregtisë.

Pasi që pyetësori u finalizua, ai u shpërnda online përmes një emaili zyrtar tek firmat e mostruara së bashku me udhëzime të hollësishme se si të plotësohet. Atyre firmave që kishin vështirësi ta plotësonin pyetësorin siç duhet iu dha ndihmë e mëtejshme përmes telefonit. Firmat që nuk pranuan të përgjigjen u zëvendësuan me firma të ngjashme. Procesi i anketës monitorohej vazhdimisht për të verifikuar në kohë saktësinë e përgjigjeve në pyetësorët e plotësuar. Pyetësori me të dhënat e mbledhura u fut automatikisht në një bazë të dhënash në Excel dhe u etiketua siç duhet. Pas adresimit të gabimeve eventuale të specifikimit, u gjeneruan tabela dhe grafikë përshkrues. Në fund u organizua një takim me përfituesin për t’i validuar gjetjet e gjeneruara, dhe drafti i raportit u nda me akterin e intervistuar për komente.

3. Trendet ndërkombëtare

Sektori i logjistikës luan rol vital në produktivitetin dhe zhvillimin ekonomik. Ndërsa kostoja e logjistikës si përqindje e BPV-së është rreth 7 për qind në vendet e OECD-së, ajo shkon deri në 25 për qind në disa vende në zhvillim.⁴ Për më tepër, hulumtimi i Bankës Botërore në vendet e Amerikës Latine tregon se ulja e pjesës së kostove të logjistikës në çmimin përfundimtar të mallrave për 14 për qind mund të rrisë kërkesën për ato mallra deri në 18 për qind dhe të rrisë punësimin në atë sektor deri në 16 për qind.⁵ Me ritmin e ri të digjitalizimit dhe evoluimit të pritjeve të klientëve, sektori i logjistikës ka kaluar nëpër ndryshime të papara në vitet e fundit, të cilat kanë kontribuar në riformimin e peizazhit të sektorit. Këto ndryshime kanë paraqitur kufizime për disa pjesëmarrës në treg, ndërsa për disa të tjerë ato janë përdorur si mundësi për rritje. Ky seksion përmbledh trendet kryesore që ndodhin në shërbimet logjistike. Këto trende duhet të merren në konsideratë nga politikë-bërësit në Kosovë.

a) Kontraktimi (ang. "outsourcing") i shërbimeve logjistike

Në ditët e sotme, prodhuesit e industrive të ndryshme po përqendrohen gjithnjë e më shumë në funksionet e tyre thelbësore të biznesit, ndërsa kontraktojnë tek palët e treta aktivitete logjistike si transporti, magazinimi, kontrolli i inventarit dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Ky trend i ri njihet gjithashtu si logjistikë e palëve të treta (3PL). Këta operatorë kanë më shumë ekspertizë, e cila mundëson të ketë nivel më të lartë të fleksibilitetit të operimeve logjistike për të mbuluar zona më të gjera gjeografike, me efikasitet më të madh dhe cilësi më të mirë të shërbimit. Globalizimi me kanale të zgjeruara të shpërndarjes së produkteve, prodhimi mu në kohë "just in time" (JIT) dhe tregtia elektronike janë kontribuuesit kryesorë në rritjen e kërkesës për 3PL. Në të gjithë botën, kompanitë 3PL po rriten dhe specializohen në ofrimin e një game të plotë të shërbimeve të integruara logjistike. Tregu global për 3PL u vlerësua të ishte 1,027.7 miliardë dollarë amerikanë në vitin 2019, dhe parashikimet janë që të arrijë deri në 1,789.9 miliardë dollarë amerikanë deri në vitin 2027.⁶

b) Mungesat e talenteve

Mungesat e fuqisë punëtore në sektorin e logjistikës përbëjnë një nga sfidat më të ngutshme – rreth 70 për qind e kompanive që operojnë në këtë sektor përjetojnë një mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar të logjistikës. Menaxherët nga vendet e Evropës Perëndimore thonë se brezat e rinj nuk shohin karrierën në logjistikë si diçka që ua përmbushë apetitet atyre.⁷ DHL, një nga kompanitë më të mëdha në industri në nivel global, e ka pranuar publikisht këtë problem, duke e etiketuar atë si një "krizë talentesh".⁸ Në vendet në zhvillim, presionet konkurruese nga fusha të tjera si financat dhe TI kontribuojnë në mungesën e talenteve në sektorin e logjistikës. Vlen të përmendet se as universitetet apo shkollat trajnuese nuk

⁴ ICF (2020) The Impact of COVID-19 on Logistics (shqip: Ndikimi i COVID-19 në logjistikë). Në dispozicion në: https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/2d6ec419-41df-46c9-8b7b-96384cd36ab3/IFC-Covid19-Logistics-final_web.pdf?MOD=AJPERES&CVID=naqOED5

⁵ Julio Gonzalez, et al. Improving Logistics Costs for Transportation and Trade Facilitation (shqip: Përmirësimi i kostove të logjistikës për lehtësimin e transportit dhe tregtisë). Banka Botërore, mars 2008.

⁶ Allied Market Research (2019). 3PL Market Size and Share (shqip: Madhësia dhe pjesa e tregut e 3PL).

⁷ Handfield.R et al (2013). Trends and Strategies in Logistics and Supply Chain Management (shqip: Trendet dhe strategjitë në logjistikë dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit). Në dispozicion në:

⁸ Transport and Logistics: Challenges and Trends in 2021 (shqip: Transporti dhe logjistika: sfidat dhe trendet në vitin 2021). Në dispozicion në: <https://www.mitrefinch.co.uk/blog/time-and-attendance/transport-logistics-challenges-trends-2021/>.

ofrojnë programe të mjaftueshme logjistike për të tërhequr studentë dhe për t'i përmbushur nevojat e tregut.

c) Digjitalizimi

Në ditët e sotme, modelet digjitale të biznesit dhe platformat digjitale janë jo vetëm më të pranishme në logjistikë por edhe në shumë fusha të tjera të sektorit të logjistikës, si për shembull, në magazinim. Integrimi i platformave digjitale në modelin e biznesit të kompanive të logjistikës ka çuar në efikasitet dhe transparencë më të lartë të zinxhirit të furnizimit. Platformat "Internet of things" (IoT), për shembull, mundësojnë zinxhirë furnizues transparentë dhe të përgjegjshëm duke lokalizuar dhe gjurmuar rrjedhën e mallrave në kohë reale. Duke përdorur pajisje të lëvizshme dhe sensorë, automjetet dhe pajisjet e tjera logjistike bëhen nyje në IoT. Sistemet e pozicionimit dhe navigimit automatik, si dhe sistemet e procesimit, rrugëtimit (ang. "routing") dhe planifikimit (ang. "scheduling") të urdhrave në kohë reale parashikohen të zgjerohen.

d) Inteligjenca artificiale dhe të dhënat e mëdha (ang. "big data")

Përdorimi i të dhënave në planifikimin dhe menaxhimin e logjistikës ka qenë shtytësi kryesor i inovacionit në këtë sektor në vitet e fundit. Kompanitë e logjistikës janë duke integruar algoritme të të mësuarit makinerik në sistemet e tyre për t'i përmirësuar rrugët (ang. "routes") dhe për të parashikuar kërkesën në tregje të caktuara. Në të ardhmen, kompanitë me shumë gjasë do të vazhdojnë të rrisin përdorimin e inteligjencës artificiale dhe të dhënave të mëdha, të cilat pritet të kenë rol vendimtar në aftësitë e përparuara gjeokoduese, optimizimin e rrugës, parashikimin e kërkesës, automatizimin e magazinës.⁹

e) Logjistika e gjelbër

Një trend tjetër i rëndësishëm që sot po formëson sektorë të ndryshëm është kërkesa e rritur për qëndrueshmëri, dhe sektori i logjistikës nuk përbën përjashtim në këtë drejtim. Transporti, në të vërtetë, është një pjesë e madhe e kontributeve të gazrave serrë. Qëndrueshmëria është bërë domosdoshmëri për të mbetur relevant. Operatorët po bëhen më rajonale për të pasur rrugë më të shkurtra dhe për t'i ulur emetimet si rezultat i kësaj. Ndërmodaliteti, i cili është një kombinim i dy ose më shumë mënyrave të transportit, tani konsiderohet të jetë më konkurrues dhe më pak ndotës. Në përgjithësi, përpjekjet në rritje për qëndrueshmërinë pritet të nxisin zhvillimin në fushat kontribuuese të tilla si teknologjitë në zhvillim, lëndët djegëse alternative dhe zinxhirët alternativë të furnizimit.

f) Tregtia elektronike

Pandemia COVID-19 e ka vendosur tregtinë elektronike në ballë të shitjes me pakicë. Para shpërthimit të pandemisë, tregtia elektronike po rritej me një ritëm prej 4.5 për qind në vit.¹⁰ Pasi u vendosën masat e bllokimit, ka pasur një rritje të paparë si në tregtinë elektronike biznes-me-konsumator (B2C) ashtu edhe në tregtinë elektronike biznes-me-biznes (B2B). Ky trend pritet të vazhdojë edhe pas largimit të

⁹ Trans Global. Top Logistics and Transportation Trends that will Shape 2020 and Beyond (shqip: Trendet kryesore të logjistikës dhe transportit që do të formësojnë 2020-tën dhe më tej). Në dispozicion në: <https://tgal.us/top-logistics-and-transporting-trends-for-2020/>.

¹⁰ Totolo.E dhe Baijal. H. (2020) Në dispozicion në: <https://blogs.worldbank.org/psd/how-pandemic-induced-boom-e-commerce-can-reshape-financial-service>

bllokimeve. Pritet që deri në vitin 2040, rreth 95 për qind e blerjeve në të gjithë botën do të bëhen online.¹¹ Ndryshimet e shpejta në sektorin e shitjes me pakicë kanë krijuar mundësi për kompanitë e logjistikës. Aftësia e kompanive për të adaptuar teknologji dhe zgjidhje të reja do të jetë jetike në përcaktimin e kapacitetit të tyre për të përmbushur nevojat e reja.

g) Robotika

Integrimi i robotikës në logjistikë ka kontribuar në rritjen e shpejtësisë dhe saktësisë në operime. Shumë kompani në sektorin e logjistikës janë duke përdorur robotë fizikë, të tillë si robotë bashkëpunues ("co-bots") për të marrë mallra në depo dhe objekte të magazinimit. Krahas robotëve fizikë, kompanitë janë duke përdorur edhe robotë softuerë për të kryer detyra të përsëritura që u kursejnë kohën burimeve njerëzore.

¹¹ Transport and Logistics: Challenges and Trends in 2021 (shqip: Transporti dhe logjistika: sfidat dhe trendet në vitin 2021". Në dispozicion në: <https://www.mitrefinch.co.uk/blog/time-and-attendance/transport-logistics-challenges-trends-2021/>.

4. Struktura dhe performanca e sektorit të logjistikës në Kosovë

Ky seksion paraqet makrostrukturën dhe performancën e sektorit të logjistikës, duke u mbështetur në statistikat nga burimet kryesore administrative. Në disa pjesë, ai gjithashtu bën krahasime me të dhënat e BE-së. Sektori i logjistikës bie nën ndarjet 49 deri 53 të Klasifikimit të BE-së NACE Rev 2. Aktivitetet ekonomike nën këto ndarje përfshijnë gjithashtu transportin e udhëtarëve, i cili nuk është pjesë e sektorit të logjistikës. Për të hequr transportin e udhëtarëve dhe për të dhënë një pamje më të detajuar, ishte e nevojshme që analiza të kryhej duke përdorur të dhëna të nivelit tre shifror. Aktivitetet e sakta të konsideruara janë paraqitur më poshtë. Ky grup i aktiviteteve paraqet bazën për analizën e mëposhtme. Kini parasysh që aktivitetet ekonomike të konsideruara përfshijnë vetëm shërbimet logjistike të ofruara nga operatorët. Shërbimet që kompanitë i kryejnë me staf të brendshëm (ang. "in house") nuk janë përfshirë në analizë, pasi nuk kishte të dhëna në dispozicion.

Nga "Ndarja" 49 Transporti tokësor dhe transporti përmes tubacioneve:

- 49.2 - Transporti hekurudhor i mallrave
- 49.4 - Transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes
- 49.5 - Transporti përmes tubacioneve

Nga "Ndarja" 50 Transporti ujor:

- 50.2 - Transporti detar dhe bregdetar i mallrave
- 50.4 - Transporti i brendshëm ujor i mallrave

Nga "Ndarja" 51 Transport ajror:

- 51.2 - Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor

Nga "Ndarja" 52 Magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport:

- 52.1 - Magazinimi dhe ruajtja
- 52.2 - Aktivitete mbështetëse për transport

Nga "Ndarja" 53 Veprimtaritë postare dhe të ndërlidhjes postare:

- 53.2 - Veprimtaritë e tjera postare dhe të ndërlidhjes

Në Kosovë, numri i firmave aktive të logjistikës ndryshon në varësi të burimit. Dy burimet kryesore për të dhëna të tilla janë Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Tabela 1 krahason firmat aktive të logjistikës sipas këtyre dy burimeve. Numri i përgjithshëm i firmave aktive në këtë sektor, sipas të dhënave të ARBK-së, është 2,829; ndryshe nga kjo, të dhënat e ATK-së tregojnë se ka rreth 50 për qind më pak firma. Mund të ndodhë që numrat e ARBK-së të paraqesin një pamje të ekzagjeruar për shkak se përfaqësuesit e firmave në Kosovë përgjithësisht nuk e marrin mundin t'i mbyllin zyrtarisht firmat e tyre në rastet kur ndërpresin aktivitetin e tyre. Duke pasur parasysh këtë, numri i firmave aktive siç sigurohet nga ATK duhet të merret si më i saktë. Shpërndarja e firmave aktive të logjistikës sipas nën sektorëve është shumë e ngjashme në të dy rastet. BE-ja, mesatarisht, ka dhjetë herë më shumë firma të logjistikës sesa Kosova kur krahasohet me të dhënat e

ARBK-së, dhe 20 herë më shumë kur krahasohet me të dhënat e ATK.¹² Kur krahasohet për kokë banori, Spanja, që është vendi me numrin më të madh të firmave të logjistikës në BE, ka dy ose katër herë (në varësi të burimit, goftë ARBK ose ATK) më shumë firma krahasuar me Kosovën.

Një analizë në nivelin e nën-sektorit zbulon se në vitin 2019, shumica e firmave aktive që paraqiten në ATK, 57.4 për qind, bien nën 'transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes'; ndërsa 'aktivitetet mbështetëse për transportin' vijon me 34.6 për qind. Në BE, nën-sektori i transportit rrugor mban dukshëm më së shumti ndërmarrje, rreth 75 për qind në total.¹³

Tabela 1: Numri i firmave aktive të logjistikës, sipas nën sektorëve

Nace Rev 2 - Përshkrimi	ARBK (2020)		ATK (2020)	
H49.2 - Transporti hekurudhor i mallrave	5	0.2%	5	0.4%
H49.4 - Transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes	1,741	61.5%	796	57.4%
H49.5 - Transporti përmes tubacioneve	7	0.2%	3	0.2%
H50.2 - Transporti detar dhe bregdetar i mallrave	6	0.2%	6	0.4%
H50.4 - Transporti i brendshëm ujor i mallrave	22	0.8%	10	0.7%
H51.2 - Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor	2	0,1%	12	0,0%
H52.1 - Magazinimi dhe ruajtja	58	2.1%	24	1.7%
H52.2 - Aktivitete mbështetëse për transport	933	33.0%	480	34.6%
H53.2 - Veprimtaritë tjera postale dhe të ndërlidhjes	55	1.9%	51	3.7%
TOTALI I FIRMAVE AKTIVE NË LOGJISTIKË	2,829	100.0%	1,387	100.0%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ARBK-së dhe ATK-së.

Tabela 2 paraqet numrin e firmave të logjistikës të regjistruara dhe të mbyllura në Kosovë nga viti 2001 deri në vitin 2020, sipas të dhënave të ARBK-së. Gjatë kësaj periudhe, një total prej 2,454 firmave të logjistikës janë regjistruar në Kosovë. Numri më i madh i firmave u themeluan në periudhën pas luftës, midis viteve 2000 dhe 2004. Në katër vitet e ardhshme (2005-2008) kishte pasur një rënie të dukshme të numrit të firmave të reja të logjistikës, që pastaj u pasua nga rritje të qëndrueshme në periudhat pasuese. Nga ana tjetër, numri i firmave të logjistikës që ishin mbyllur gjatë periudhës që i nënshtrohej analizës ishte shumë më i vogël, 291. Siç u tregua më parë, kjo nuk do të thotë që të gjitha ato që nuk duket se janë të mbyllura janë akoma duke operuar. Numri i firmave të mbyllura të logjistikës ndryshon pa ndonjë model specifik.

Tabela 2: Firmat e regjistruara dhe të mbyllura të logjistikës (2001-2020)

Vitet	Themeluar	Mbyllur
2000-2004	1,053	92
2005-2008	349	58
2009-2012	465	101
2013-2016	478	54


¹² Analysis of the EU logistics sector (shqip: Analiza e sektorit të logjistikës së BE-së). Në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/transport/sites/transport/files/themes/strategies/studies/doc/2015-01-freight-logistics-lot1-logistics-sector.pdf>

¹³ Po aty.

2017-2020	484	10
Totali	2,454	291

Të dhënat e ndara sipas rajoneve janë siguruar vetëm nga ATK-ja. Sipas të dhënave, 40.6 për qind e firmave aktive të logjistikës janë të vendosura në rajonin e Prishtinës. Ferizaj dhe Prizreni janë dy rajonet vijuese me 17.1 për qind dhe 15.3 për qind, përkatësisht. Nga ana tjetër, rajoni me numrin më të vogël të firmave aktive të logjistikës është Gjakova me 1.7 për qind (shih Figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja e firmave aktive të logjistikës (sipas të dhënave të ATK-së) sipas rajoneve



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ATK-së.

Për sa i përket statusit ligjor, siç përshkruhet në Figurën 2, 53.4 për qind e firmave të logjistikës të regjistruara në ARBK janë biznese individuale; 46.6 për qind janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.); dhe pjesa tjetër përbëhet nga partneritete të përgjithshme (1.4 për qind) dhe kompani të huaja (1.1 për qind). Kini parasysh që në këtë rast janë konsideruar vetëm të dhënat nga viti 2008 e tutje, sepse para këtij viti kishin ekzistuar disa forma të ndryshme të klasifikimit ligjor.


Figura 2: Firmat e logjistikës (sipas të dhënave të ARBK-së) sipas gjinisë së pronarëve



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ARBK-së.

Figura 3 tregon që 87.1 për qind e firmave të logjistikës, sipas të dhënave të ARBK-ë, janë në pronësi të burrave, ndërsa 12.9 për qind në pronësi të grave ose me pronësi të përzier. Kjo përqindje gjenerohet duke përdorur të dhëna nga viti 2015 e tutje, pasi nuk ka pasur dëshmi të rregullta para këtij viti.

Figura 3: Firmat e logjistikës sipas gjinisë



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ARBK-së.

Të dhënat e Vlerës së Shtuar Bruto (GVA) në Kosovë prodhohen vetëm në nivelin e ndarjes. Në këtë nivel të ndarjes përfshihen edhe vlerat e krijuara nga transporti i udhëtarëve dhe disa aktivitete postare të cilat nuk konsiderohen pjesë e sektorit të logjistikës. Për t'i zbritur këto vlera, autori gjeneroi koeficientë që rrjedhin nga përpjesëtimet në të dhënat e punësimit të ofruara nga ATK-ja dhe i aplikoi përkatësisht në nën sektorët ku bënin pjesë aktivitetet e logjistikës. Prandaj, të dhënat në Tabelën 3, megjithëse paraqiten në nivelin e ndarjes (dyshifrore), përfshijnë vetëm vlerat e krijuara nga aktivitetet e logjistikës.

Në vitin 2019, pjesa e logjistikës në Vlerën e Shtuar Bruto (GVA) të Kosovës qëndroi në 3.2 për qind, duke shënuar një rritje prej 1 pikë përqindjeje (pp) krahasuar me vitin 2017. Kjo përqindje është përgjithësisht e ulët krahasuar me BE-në, ku mesatarja qëndron në rreth 7 për qind.¹⁴ Në BE, Gjermania është vendi më i madh i logjistikës, që përfshin rreth një të katërtën e madhësisë së tregut. 'Magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport' dhe 'transporti tokësor dhe transporti përmes tubacioneve' kanë qenë dy nën sektorët kryesorë që kanë përbërë pothuajse të gjithë GVA-në e Kosovës në sektorin e logjistikës në periudhën që i nënshtrohej analizës.

Tabela 3: GVA në sektorin e logjistikës në Kosovë

NACE Rev 2 - Përshkrimi	GVA 2017		GVA 2018		GVA 2019	
	Në 000' EUR	%	Në 000' EUR	%	Në 000' EUR	%
H49 - Transport tokësor dhe transporti përmes tubacioneve ¹⁵	109,576.5	47.5%	117,408.0	45.4%	26,685.3	16.3%
H50 - Transporti ujor	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%
H51 - Transport ajror ¹⁶	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%
H52 - Magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport	103,495.6	44.9%	124,194.7	48.0%	134,500.7	82.4%
H53 - Veprimtaritë postare dhe të ndërlidhjes postare ¹⁷	17,376.6	7.5%	17,269.0	6.7%	2,093,0	1.3%
TOTALI	230,448.7	100%	258.871,7	100.0%	163,279.0	100.0%
Përqindja (%) në GVA-në e përgjithshme		2.2%		2.8%		3.2%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ASK-së dhe ATK-së.

Përveç GVA-së, qarkullimi është gjithashtu një tregues i rëndësishëm për të treguar performancën e sektorit dhe nën sektorëve të logjistikës. Siç tregon Tabela 4, sektori i logjistikës ka kontribuar me 1.3 për qind në qarkullimin e kombinuar të firmave të Kosovës gjatë periudhës 2017-2019. Megjithatë përqindja nuk ka ndryshuar gjatë viteve, vlera e qarkullimit në sektorin e logjistikës është rritur nga 134.8 milionë EUR në vitin 2017 në 166.3 milionë EUR në vitin 2019. Fakti që përqindja ka mbetur e pandryshuar sugjeron që rritja në sektorin e logjistikës ka shkuar paralelisht me rritjen e qarkullimit të përgjithshëm të firmave të Kosovës, me të gjithë sektorët e përfshirë.

Tabela 4: Qarkullimi i kombinuar i firmave të logjistikës (2017-2019)

NACE Rev 2 - Përshkrimi	Qarkullimi në vitin 2017		Qarkullimi në vitin 2018		Qarkullimi në vitin 2019	
	Në 000' EUR	%	Në 000' EUR	%	Në 000' EUR	%
H49.2 - Transport hekurudhor i mallrave	42.0	0,0%	116.1	0,1%	170.16	0.10%
H49.4 - Transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes	106,434.4	79.0%	124,644.9	80.2%	131,953.6	79.3%
H49.5 - Transporti përmes tubacioneve	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Koeficientët e aplikuar: 19.30% për vitin 2017, 21.30% për vitin 2018, dhe 21.80% për vitin 2020.

¹⁶ Koeficientët e aplikuar: 0% në të gjitha vitet pasi nuk ka transport ajror të mallrave.

¹⁷ Koeficientët e aplikuar: 4.1% për vitin 2017, 4.9% për vitin 2018, 12.0% për vitin 2019.

H50.2 - Transporti detar dhe bregdetar i mallrave	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%
H50.4 - Transporti i brendshëm ujor i mallrave	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%
H51.2 - Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor	-	0,0%	-	0,0%	-	0,0%
H52.1 - Magazinimi dhe ruajtja	5,030,5	3.7%	3,705,40	2.4%	965.5	0,5%
H52.2 - Aktivitete mbështetëse për transport	22,472.5	16.7%	25,710.0	16.5%	31,508.6	18.9%
H53.2 - Veprimtaritë e tjera postare dhe të ndërlidhjes	827.4	0.6%	1,312,6	0.8%	1,783.80	1.1%
TOTALI I QARKULLIMIT NË LOGJISTIKË	134.806.8	100.0%	155,489.0	100.0%	166.381.7	100.0%
Përqindja (%) në totalin e qarkullimit		1.3%		1.3%		1.3%

Tabela 5 tregon numrin e personave të punësuar në nivelin tre shifror të Nace Rev 2 për vitet 2018 dhe 2019, bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) të kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). ASK-ja ka filluar të prodhojë të dhëna për punësimin në këtë nivel të ndarjes duke filluar nga viti 2018, dhe kjo është arsyeja pse, ndryshe nga rasti i treguesve të tjerë, viti 2017 nuk mund të përfshihej. Sipas të dhënave, numri i personave që ishin të punësuar në vitin 2019 në sektorin e logjistikës ishte 4.134, që përbënte rreth 1.2 për qind të numrit të përgjithshëm të personave të punësuar në Kosovë. Krahasuar me vitin 2018, ka pasur një rritje prej 32.4 për qind. Një ndarje nga nën sektori zbulon se 'transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes' mban përqindjen më të madhe të personave që ishin të punësuar në vitin 2019 me 46.8 për qind, pasuar nga 'aktivitete mbështetëse për transport' me 25.5 për qind, dhe 'magazinimi dhe ruajtja' me 16.1 për qind. Të gjithë nën sektorët e konsideruar kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2018, përveç 'veprimtaritë e tjera postare dhe të ndërlidhjes', që ka shënuar rënie prej rreth 40 për qind.

Tabela 5: Personat e punësuar në sektorin e logjistikës (2018-2019)

NACE Rev 2 - Përshkrimi	Personat e punësuar (2018)		Personat e punësuar (2019)	
	#	%	#	%
H49.2 - Transport hekurudhor i mallrave	-	0,0%	-	0,0%
H49.4 - Transporti rrugor i mallrave dhe shërbimet e zhvendosjes	1,116	35.7%	1,935	46.8%
H50.2 - Transporti detar dhe bregdetar i mallrave	-	0,0%	-	0,0%
H50.4 - Transporti i brendshëm ujor i mallrave	-	0,0%	-	0,0%
H51.2 - Transporti ajror i mallrave dhe transporti hapësinor	-	0,0%	-	0,0%
H52.1 - Magazinimi dhe ruajtja	350	11.2%	664	16.1%
H52.2 - Aktivitete mbështetëse për transport	781	25.0%	1,011	24.5%
H53.2 - Veprimtaritë e tjera postare dhe të ndërlidhjes	876	28.0%	524	12.7%
TOTALI I TË PUNËSUARVE NË LOGJISTIKË	3,123	100.0%	4,134	100.0%
Përqindja (%) në punësimin total (ATK)		0.9%		1.2%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e ASK-së.

Në Kosovë, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është përgjegjëse për prodhimin e të dhënave të tregtisë së shërbimeve duke përdorur metodologjinë BPM6 nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Të dhënat e prodhuara deri më tani, siç tregohet në Tabelën 6, nuk ndahen në një nivel që përshkruan vëllimin e tregtisë sipas secilës mënyrë transporti. Për më tepër, BQK-ja nuk mbledh të dhëna tregtare për magazinimin. Sidoqoftë, nga të dhënat në dispozicion, të cilat përfshijnë transportin ajror të mallrave, mënyrat e tjera të transportit të mallrave dhe shërbimet postare dhe të ndërlidhjes, shihet se Kosova ka përjetuar një deficit jashtëzakonisht të madh tregtar në sektorin e transportit të mallrave gjatë periudhës 2017-2019. Për shkak se shkalla e rritjes së importeve ka qenë më e lartë se ajo e eksporteve, deficitit është rritur nga një shumë prej 88.5 milionë EUR në vitin 2017 në 97.8 milionë EUR në vitin 2019. Gjatë këtyre tri viteve, mënyrat e tjera të transportit të mallrave, të cilat mund të konsiderohen transport tokësor i mallrave (pasi nuk ka transport ujor në Kosovë), përbëjnë përqindjen më të madhe në totalin e tregtisë dhe deficitit brenda sektorit. Për informacion më të hollësishëm, shihni Tabelën 6. Në fakt, transporti i mallrave është një nga sektorët me performancën më të keqe në tregtinë e shërbimeve në Kosovë, në mos më i keqi. Për t'i parë gjërat në perspektivë, Kosova ka shënuar suficit në tregtinë e shërbimeve në përgjithësi gjatë viteve të fundit.

Tabela 6: Tregtia e transportit të mallrave

Kategoritë BPM6 të FMN-së	Tregtia në 000' EUR (2017)				Tregtia në 000' EUR (2018)				Tregtia në 000' EUR (2019)			
	Kredi	Debi	Totali	Bilanci	Kredi	Debi	Totali	Bilanci	Kredi	Debi	Totali	Bilanci
<i>Transporti ajror (i mallrave)</i>	-	-	-	-	10	-	10	10	50	140	190	(90)
<i>Mënyrat e tjera të transportit (të mallrave)</i>	280	87,730	88,010	(87,450)	330	87,730	88,060	(87,400)	2,420	99,660	102,080	(97,240)
<i>Shërbimet postare dhe të ndërlidhjes</i>	210	1270	1,480	(1,060)	260	1460	1,720	(1,200)	10	510	520	(500)
TOTAL	490	89,000	89,490	(88,510)	600	89,190	89,790	(88,590)	2,480	100.310	102,790	(97,830)

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e BQK-së.

Një indeks popullor që mat performancën logjistike të vendeve në të gjithë botën është Indeksi i Performancës së Logjistikës (LPI) i krijuar nga Banka Botërore (BB).¹⁸ Aktualisht janë 160 vende që marrin pjesë në LPI. LPI bazohet në një anketë mbarë botërore të operatorëve që ofrojnë informacion mbi gjendjen e logjistikës në vendet e tyre si dhe në vendet me të cilat tregtojnë. Komentet nga operatorët plotësohen me të dhëna sasiore mbi performancën e përbërësve kryesorë të zinxhirit të logjistikës. Edhe pse kjo është një performancë shumë e rëndësishme, veçanërisht për qëllime krahasimi, Kosova ende nuk është pjesë e saj.

¹⁸ Banka Botërore. Logistics Performance Index (shqip: Indeksi i Performancës Logjistike). Në dispozicion në: <https://lpi.worldbank.org/>

5. Korniza rregullatore

